



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.174

16 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1104, datë 19.11.2009	Për shtyrjen e afatit të shpalljes e të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Mbrojtjes, si autoritet kontraktor	7713
Vendim i KM nr.1105, datë 18.11.2009	Për shtyrjen e afatit të zhvillimit të procedurave të disa prokurimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor	7714
Vendim i KM nr.1106, datë 18.11.2009	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Brendshme, si autoritet kontraktor.....	7714
Vendim i KM nr.1107, datë 18.11.2009	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Garda e Republikës, si autoritet kontraktor	7715
Vendim i KM nr.1157, datë 25.11.2009	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	7716
Vendim i KM nr.1158, datë 25.11.2009	Për miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Luksemburg, më 14 prill 2005	7717
Vendim i KM nr.1160, datë 25.11.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.984, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve dhe “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010”, të ndryshuar	7722

Vendim i KM nr.1161, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i niveli të parë”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	7723
Vendim i KM nr.1162, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe studimi	7724
Vendim i KM nr.1164, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi	7725
Vendim i KM nr.1165, datë 25.11.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca komunikimi”, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për këtë program studimi	7726
Vendim i KM nr.1166, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit dhe të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi	7727
Vendim i KM nr.1167, datë 25.11.2009	Për disa shtesa në vendimin nr. 855, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës”	7728
Vendim i KM nr.1168, datë 25.11.2009	Për disa shtesa në vendimin nr. 825, datë 29.7.2009, të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotave dhe të tarifës për këtë program”	7728
Vendim i KM nr.1169, datë 25.11.2009	Për disa shtesa në vendimin nr. 854, datë 5. 8. 2009, të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në atë të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës”	7729
Vendim i KM nr.1170, datë 25.11.2009	Për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), dhe për miratimin e kuotës së pranimeve dhe të tarifës së shkollimit për këtë program studimi, në Universitetin e Tiranës	7729
Vendim i KM nr. 1193, datë 3.12.2009	Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të pyetësorit të Komisionit European, në kuadër të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European	7730
Vendim i KM nr.1197, datë 3.12.2009	Për shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A”” dhe miratimin e rregullores së administrimit të saj	7731

Udhëzim i MF nr.47, datë 26.11.2009	Për mënyrën dhe afatet e kryerjes së pagesës së detyrimeve ligjore të subjekteve të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit	7732
Kërkesë e MPPTT nr.7163, datë 8.12.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor“Rruga Kodër Kamëz-Kamëz”	7733
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Lutfi Mara.....	7735

VENDIM
Nr.1104, datë 19.11.2009

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË
FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E
PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të strukturave në varësi të saj të përfundojnë, brenda datës 20 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2009, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati, të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës të nënshkruar, në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E OBJEKTEVE, LLOJIN E PROCEDURËS DHE AFATET MAKSIMALE
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PROKURIMIT**

1. Makineri e pajisje në funksion të projektit “Damen”.
2. Blerje vajra lubrifikante për anijet e prodhuara nga kontrata me shoqërinë “Damen”.
3. Studim projektim i Qendrës Kulturore të Ushtrisë dhe Hoteli i Ushtarakëve.
4. Blerje veshmbathje dhe uniforma për Forcat e Armatosura.
5. Shtesë kontrate në KDS për përshtatjen e kabinës elektrike në qendrën e gjuhëve të huaja.
6. Shtesë kontrate në “Kabina elektrike Plepa Durrës”.
7. Rikonstruksion i sallës së kolegjiave.
8. Blerje bojrash për lyerjen e anijeve.
9. Blerje mallrash ushqimore për një periudhë 6-mujore.
10. Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve të QRM-së.

VENDIM
Nr.1105, datë 18.11.2009

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË DISA
PROKURIMEVE NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, që, brenda datës 20 dhjetor të vitit 2009, të zhvillojë procedurat e prokurimit për objektet e përcaktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Objekti i prokurimit	Autoriteti kontraktor
1.	Studim projektim rruga Koman-Fierzë	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
2.	Studim projektim rruga Elbasan-Berat	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve

VENDIM
Nr.1106, datë 18.11.2009

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E BRENDSHME, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lejimin e Ministrisë së Brendshme të realizojë, brenda datës 20 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, për objektet e specifikuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit në lekë	Objekti i prokurimit	Shënim
1.	Ministria e Brendshme	1 418 699 834	Ushqim i gatuar (katering) për Forcat e Armatosura	Njoftim fituesi
2.	Ministria e Brendshme	188 416 656	Blerje materiale kancelarie, letër dhe tonera për Kryeministrinë, ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre	Njoftim fituesi
3.	Ministria e Brendshme	370 792 500	“Blerje automjesh”, Loti I: Blerje autovetura për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit	Njoftim fituesi
4.	Ministria e Brendshme	1 420 693	“Blerje karburanti D2 (diesel) për Ministrinë e Drejtësisë	Njoftim fituesi
5.	Ministria e Brendshme	191 314 832	Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni	Njoftim fituesi
6.	Ministria e Brendshme	12 529 755	Blerje pjese ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike, në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi

VENDIM

Nr.1107, datë 18.11.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA GARDA E REPUBLIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Gardës së Republikës të përfundojë, brenda datës 7 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse e publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Garda e Republikës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	Autoriteti kontraktor	Vlera e prokurimit	Objekti i prokurimit	Shënim
1.	Garda e Republikës	1 333 333 lekë	Riparim pajisje të ndryshme kazermimi	Rishpallur 3 herë
2.	Garda e Republikës	590 833 lekë	Blerje pajisje kimie	Rishpallur 3 herë
3.	Garda e Republikës	500 000 lekë	Hapje dhe studim pusi	Rishpallur 3 herë
4.	Garda e Republikës	416 667 lekë	Blerje materialesh të ndryshme ndërlihdjeje	Rishpallur 3 herë
5.	Garda e Republikës	250 000 lekë	Riparim pajisjesh të ndryshme ndërlihdjeje	Rishpallur 3 herë

VENDIM
Nr.1157, datë 25.11.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË BORDEVE TË KULLIMIT, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, listë e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Në këtë listë përfshihen:

- Bordi i kullimit, Berat, (ushtron funksionin në Berat, Kuçovë e Skrapar, në qarkun e Beratit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë dhe ka 2 296 (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Durrës, (ushtron funksionin në Durrës e Krujë, në qarkun e Durrësit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 42 (dyzet e dy) fletë dhe ka 656 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Elbasan, (ushtron funksionin në Elbasan, Gramsh e Librazhd, në qarkun e Elbasanit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë dhe ka 732 (shtatëqind e tridhjetë e dy) pasuri.

- Bordi i kullimit, Fier, (ushtron funksionin në Fier e Mallakastër, në qarkun e Fierit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë dhe ka 1 648 (një mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Gjirokastrë, (ushtron funksionin në Gjirokastrë, Përmet e Tepelenë, në qarkun e Gjirokastrës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 43 (dyzet e tre) fletë dhe ka 520 (pesëqind e njëzet) pasuri.

- Bordi i kullimit, Kavajë, (ushtron funksionin në Kavajë, në qarkun e Tiranës dhe Peqin, në qarkun e Elbasanit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 30 (tridhjetë) fletë dhe ka 361 (treqind e gjashtëdhjetë e një) pasuri.

- Bordi i kullimit, Korçë, (ushtron funksionin në Korçë, Devoll e Kolonjë, në qarkun e Korçës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 101 (njëqind e një) fletë dhe ka 1 719 (një mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Kukës, (ushtron funksionin në Kukës, Has e Tropojë, në qarkun e Kukësit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 33 (tridhjetë e tre) fletë dhe ka 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Lezhë, (ushtron funksionin në Lezhë, Laç e Mirditë, në qarkun e Lezhës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 44 (dyzet e katër) fletë dhe ka 697 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Lushnjë, (ushtron funksionin në Lushnjë, në qarkun e Fierit). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 53 (pesëdhjetë e tre) fletë dhe ka 930 (nëntëqind e tridhjetë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Mat, (ushtron funksionin në Peshkopi, Mat e Bulqizë, në qarkun e Dibrës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë dhe ka 245 (dyqind e dyzet e pesë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Pogradec, (ushtron funksionin në Pogradec, në qarkun e Korçës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë dhe ka 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Sarandë, (ushtron funksionin në Sarandë e Delvinë, në qarkun e Vlorës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 27 (njëzet e shtatë) fletë dhe ka 351 (treqind e pesëdhjetë e një) pasuri.

- Bordi i kullimit, Shkodër, (ushtron funksionin në Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë, në qarkun e Shkodrës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 41 (dyzet e një) fletë dhe ka 515 (pesëqind e pesëmbëdhjetë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Tiranë, (ushtron funksionin në Tiranë, në qarkun e Tiranës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 29 (njëzet e nëntë) fletë dhe ka 299 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) pasuri.

- Bordi i kullimit, Vlorë, (ushtron funksionin në Vlorë, në qarkun e Vlorës). Lista e inventarit për këtë bord përbëhet nga 27 (njëzet e shtatë) fletë dhe ka 454 (katërqind e pesëdhjetë e katër) pasuri.

Në këto lista janë, gjithsej, 795 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë inventari, me 11 957 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) pasuri.

2. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1158, datë 25.11.2009

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR, NËNSHKRUAR NË LUKSEMBURG, MË 14 PRILL 2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Luksemburg, më 14 prill 2005, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

PROTOKOLL

MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR
RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR, NËNSHKRUAR NË
LUKSEMBURG, MË 14 PRILL 2005

Palët në këtë protokoll,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Hungarisë (më poshtë referuar veçmas si palë kontraktuese dhe së bashku si palët kontraktuese),

duke dëshiruar të lehtësojnë zbatimin e marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Luksemburg, më 14 prill 2005 (në vijim e quajtur marrëveshja e ripranimit),

bazuar mbi nenin 19 të saj,

bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përcaktimi i autoriteteve kompetente dhe pikave të kontaktit

1. Në përputhje me nenin 19 (1) germa “a” të marrëveshjes së ripranimit, autoritetet kompetente të palëve kontraktuese (më poshtë referuar si autoritetet kompetente) ua kanë besuar zbatimin e saj, si më poshtë:

a) Pritja dhe procedimi i aplikimeve për ripranim:

Për palën kontraktuese shqiptare:

Ministria e Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë

Tel/faks: + 355 4 2 226 932

Tel: + 355 4 2 279 251

+ 355 4 2 279 253

+ 355 4 2 279 241

Faks: +355 4 2 279 263

e-mail:policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al

Për palën kontraktuese hungareze:

Drejtoria Kombëtare e Policisë

H-1139 Budapest, Teve u,4-6

Pika e kontaktit: Divizioni për kontrollin e të huajve

Tel: + 36 1 443 5445

Fax: + 36 1 443 5446

E-mail: idrendo@orfk.police.hu.

b) Pritja dhe procedimi i aplikimeve për tranzit:

Për palën kontraktuese shqiptare:

Ministria e Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë

Tel/faks: + 355 4 2 226 932

Tel: + 355 4 2 279 251

+ 355 4 2 279 253

+ 355 4 2 279 241

Faks: +355 4 2 279 263

e-mail: policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al

Për palën kontraktuese hungareze:

Zyra e Migracionit dhe Shtetësisë

Adresa: H-1117, Budafoki u.60, Budapest

Tel: + 36 1 463 9126

Fax: + 36 1 463 9127

e-mail" seo@bah.b-m.hu.

2. Për zbatimin e dispozitave të marrëveshjes dhe për këtë protokoll zbatimi autoritetet qendrore kompetente do të bashkëpunojnë drejtpërsëdrejti me njëra-tjetrën.

3. Palët kontraktuese do ta njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për çdo ndryshim në listën e autoriteteve kompetente referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Për zbatimin e këtij protokollit zbatues, autoritetet kompetente qendrore do ta njoftojnë njëra-tjetrën drejtpërsëdrejti me shkrim për të dhënat e kontaktit brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit zbatimi.

Neni 2

Pikat e kalimit kufitar

1. Në përputhje me nenin 19 (1), germa "a" të marrëveshjes së ripranimit, pikat e mëposhtme të kalimit kufitar janë parësisht të autorizuar nga palët kontraktuese për kalimin e kufijve të tyre respektivë, duke përfshirë aeroportet ndërkombëtare:

a) Në territorin e Republikës së Shqipërisë:

Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas

Komisariati i Policisë për Kufirin dhe Migracionin Rinas

Tiranë, Shqipëri

Tel./Fax ++ 355 4 2 364 028

e-mail: rinas@mrp.gov.al.

b) Në territorin e Republikës së Hungarisë:

- Aeroporti Ndërkombëtar i Budapestit/Ferihegy

Drejtoria e Policisë së Aeroportit

Ferihegy, Budapest

Tel: + 36 – 1 - 290 3121

Fax: + 36 – 1 – 291 9748

E-mail: rri.ugyo@rri.police.hu.

2. Autoritetet kompetente mund të bien dakord për përdorimin e pikave të tjera të kalimit kufitar në bazën e parimit rast pas rasti. Në këto raste, për datën kohën, pikat e kalimit kufitar dhe mënyrën e transferimit të personit që do të ripranohet, si dhe për modalitetet e tranzitit do të bihet dakord midis autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese në çdo rast konkret të marrë veç e veç.

Neni 3

Kushtet për kthimin e shoqëruar

Në përputhje me nenin 19 (1) germa “b” të marrëveshjes së ripranimit, palët kontraktuese bien dakord për kushtet e mëposhtme për përdorimin e eskortave në operacionet e ripranimit ose tranzitit në territoret e tyre respektive:

a) Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar do të sigurojë dhe përmbushë ripranimin e shoqëruar ose tranzitin tokësor në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

b) Gjatë ripranimi ose tranzitit, shoqëruesit ajrorë do t'i kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur dhe me veshje civile. Ata duhet të kenë me vete dokumente, që tregojnë që ripranimi ose tranziti është miratuar dhe në çdo kohë duhet të jenë në gjendje të provojnë identitetin e tyre dhe udhëzimet zyrtare.

c) Autoritetet e palës kontraktuese të kërkuar do t'u japin të njëjtën mbrojtje dhe ndihmë shoqëruesve, të cilët janë duke kryer detyrat e tyre siç u japin oficerëve të tyre të autorizuar për të njëjtën detyrë.

d) Shoqëruesit do t'i binden ligjit të palës kontraktuese të kërkuar në të gjitha rrethanat. Autoriteti i eskortës shoqëruese që shoqëron një të kthyer ose të transferuar kufizohet në vetëmbrojtje. Gjithsesi, në mungesë të ndonjë oficeri të palës kontraktuese të kërkuar, të autorizuar për të marrë masat e nevojshme ose për t'i mbështetur këta oficerë, këta shoqërues mund t'i përgjigjen një rreziku të menjëhershëm dhe serioz në një mënyrë të arsyeshme dhe përpjestimore për të evituar që një i kthyer të shkaktojë dëme ndaj vetes ose një pale të tretë, ose të shkaktojë dëme ndaj pronës.

Neni 4

Modalitetet dhe mbështetja për operacionet tranzit

Në përputhje me nenet 13 dhe 14 të marrëveshjes së ripranimit, palët kontraktuese bien dakord të ndjekin modalitetet praktike për kryerjen e operacioneve tranzite:

a) Një aplikim tranziti do të dorëzohet pa vonesë të paktën katër (4) ditë pune para tranzitit të planifikuar me faks ose elektronikisht drejt autoriteteve kompetente të palës kontraktuese të kërkuar.

b) Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar do të përgjigjet brenda dy (2) ditëve pune pas marrjes së njoftimit të operacionit të tranzitit, me faks ose elektronikisht, duke cituar gjithashtu nëse bie dakord me tranzitin dhe orarin e tij të caktuar, pikën e kalimit kufitar, mënyrën e transportit dhe përdorimin e eskortës.

c) Nëse pala kontraktuese kërkuese e gjykon të nevojshme mbështetjen e autoriteteve të palës kontraktuese të kërkuar për një operacion të veçantë tranziti, ajo do ta përmendë këtë në formularin e operacioneve tranzite (aneksi 6 i marrëveshjes së ripranimit). Në përgjigje të aplikimit të tranzitit, pala kontraktuese e kërkuar do të deklarojë nëse mund të sigurojë mbështetjen e kërkuar.

d) Nëse i transferuari udhëton në rrugë ajrore dhe nën eskortë, ruajtja dhe imbarkimi i tij do të mbulohet nga autoriteti i palës kontraktuese të kërkuar, dhe për sa është e mundur me mbështetjen e palës kontraktuese kërkuese.

Neni 5

Transferimi i personit që do të ripranohet

1. Transferimi i personit që do të ripranohet do të kryhet në kohën dhe vendin për të cilin është rënë dakord me shkrim nga autoritetet kompetente të palëve.

2. Në rast se koha e transferimit shtyhet si rezultat i disa pengesave praktike apo ligjore, autoriteti kompetent i shtetit kërkuar do ta njoftojë menjëherë autoritetin kompetent të shtetit të kërkuar për pengesat që ndodhin dhe do të tregojë vendin dhe kohën e përcaktuar të transferimit.

Neni 6

Mjetet dhe dokumentet shtesë të provës

Nëse pala kontraktuese kërkuese konsideron që dokumente të tjera të palistuar në anekset 1-4 të marrëveshjes së ripranimit mund të jenë të rëndësishme për përcaktimin e shtetësisë së personit për ripranim ose për dëshmi të kalimit të kufirit nga një shtetas i një vendi të tretë ose personi pashtetësi për ripranim, këto dokumente mund t'i dorëzohen palës kontraktuese të kërkuar së bashku me aplikimin për ripranim.

Neni 7

Procedura për intervistën e provës në lidhje me shtetësinë

Në përputhje me nenin 8 (3) të marrëveshjes së ripranimit, palët kontraktuese bien dakord për procedurën e mëposhtme të intervistës së provës në lidhje me shtetësinë:

a) Nëse autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese është i pamundur të paraqesë një nga dokumentet e listuara në anekset 1 dhe 2 të marrëveshjes, me kërkesë të tij oficerët e misionit diplomatik ose përfaqësimit konsullor të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar do të intervistojnë personin në mënyrë që të përcaktojnë nëse ai/ajo zotërojnë shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

b) Kërkesa për intervistë të provës në lidhje me shtetësinë mund t'i jepet me telefon, faks ose elektronikisht misionit diplomatik kompetent ose përfaqësimit konsullor të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar dhe do të kryhet pa vonesë të paktën dhjetë (10) ditë pune që ndjekin marrjen e kërkesës për ripranim.

c) Kërkesa për intervistë prove do të përmbajë adresën e rezidencës dhe numrin e telefonit të personit për t'u ripranuar, në mënyrë që t'ia dërgojë autoritetit kompetent të misionit diplomatik ose përfaqësimit konsullor të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar për të kontraktuar drejtpërdrejt me personin për ripranim për të përcaktuar nëse ai/ajo ka nënshtetësinë e shtetit të palës së kërkuar. Nëse misioni diplomatik kompetent ose përfaqësia konsullore e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar ka një audiencë, përfaqësuesi i autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese mund të marrë pjesë në intervistën e provës në lidhje me shtetësinë.

d) Misioni diplomatik kompetent ose përfaqësia konsullore e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar do të informojë autoritetin kompetent të palës kontraktuese kërkuese mbi përfundimet e intervistës pa vonesë, por të paktën tri (3) ditë pune nga dita e intervistës.

Neni 8

Gjuha e komunikimit

Palët kontraktuese do të komunikojnë me njëra-tjetrën në gjuhën angleze, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe.

Neni 9

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet, përveç atyre që bëhen në lidhje me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për ripranim të kryer nga pala kontraktuese e kërkuar, në lidhje me ripranimin dhe tranzitin, të cilat do të mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese në përputhje me nenin 15 të marrëveshjes së ripranimit, do të rimbursohen nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese në përputhje me kërkesat e saj buxhetore të brendshme, me dorëzimin e një fature në euro brenda 30 ditëve nga marrja e faturës.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll zbatimi do të hyjë në fuqi në ditën e 30-të (tridhjetë) që ndjek datën kur komiteti i përbashkët i ripranimit, referuar në nenin 18 të marrëveshjes të ripranimit, të jetë njoftuar. Ky njoftim do të kryhet menjëherë, pasi palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave ligjore të kërkuara për shprehjen e miratimit të tyre për t'u lidhur me këtë protokoll.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij protokoll, marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë në lidhje me ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm në territoret e tyre, nënshkruar në Tiranë, më 20 mars 2001 do të pushojë së ekzistuari.

3. Pala kontraktuese hungareze, në përputhje me nenin 19(2) të marrëveshjes së ripranimit, do ta njoftojë komitetin e përbashkët të ripranimit duke dërguar një kopje të këtij protokoll.

4. Ky protokoll lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohore. Protokollin do të pushojë së zbatuari në të njëjtën kohë me marrëveshjen e ripranimit.

5. Ky protokoll mund të amendohet nga palët kontraktuese. Ky amendim do të fillohet me shkrim përmes kanaleve diplomatike dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në paragrafin (1). Neni 1, germat "a", "b" mund të amendohet ose plotësohet me shkrim me rënien dakord përmes kanaleve diplomatike, dhe autoritetet kompetente të palëve kontraktuese informojnë njëra-tjetrën pa vonesë për amendimet ose plotësimet e nenit 1 germat "a", "b".

6. Çdo keqkuptim që mund të lindë në lidhje me këtë interpretim dhe/ose zbatimin e këtij protokollin do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve mes palëve kontraktuese brenda komisionit të përbashkët të ripranimit. Në rast se konfliktet nuk mund të zgjidhen brenda komisionit të përbashkët të ripranimit, ato do të zgjidhen nga palët kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Bërë në Tiranë, më 30 tetor 2009, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, hungareze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllor të barasvlershme. Në rast mospërputhjeje në interpretimin e këtij protokoll, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

VENDIM
Nr.1160, datë 25.11.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.984, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE DHE "MASTER I NIVELIT TË PARË", ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN
AKADEMIK 2009-2010", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.984, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën "b" të tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas numrit V shtohet numri VI, me këtë përmbajtje:

"VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë

Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 56 000 lekë.".

b) Në shkronjën "b", të tabelës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas numrit V shtohet numri VI, me këtë përmbajtje:

“VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë
Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 70 000 lekë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1161, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELI TË PARË”, NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës, DHE PËR MIRATIMIN E
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME
STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Menaxhim”, me profilet:

i) “Menaxhim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil menaxhim biznesi;

ii) “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil marketing.

b) “Politika dhe administrim”, me profilet:

i) “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim publik;

ii) “Administrim financiar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim financiar;

iii) “Drejt看 turizmi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Politika dhe administrim”, me profil drejt看 turizmi.

c) “Ekonomi-biznes”, me profilet:

i) “Drejt看 i SME-ve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Ekonomi - biznes”, me profil drejt看 i SME-ve;

ii) “Financë - Bankë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në ekonomi - biznes”, me drejt看 financë-bankë.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe studimi “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Menaxhim 30 kuota;

b) Politika dhe administrim 30 kuota;

c) Ekonomi-biznes 30 kuota.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
 7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
 8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1162, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, DHE PËR MIRATIMIN E
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME
STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, programin e studimit “Biologji mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në biologji mjedisore.

b) Në Fakultetin e Drejtësisë, programin e studimit “E drejta private dhe e biznesit”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në e drejta private dhe e biznesit.

2. Këto programe studimi të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Programet e studimit “Biologji mjedisore” dhe “E drejta private dhe e biznesit” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe studimi të ciklit të dytë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------------------|------|
| a) Biologji mjedisore | 20 ; |
| b) E drejta private dhe e biznesit | 30. |

5. Kuota e pranimeve në këto programe studimi të ciklit të dytë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për studentët, që i ndjekin këto programe studimi, si programe të dyta studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------------------|----|
| a) Biologji mjedisore | 5; |
| b) E drejta private dhe e biznesit | 5. |

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jenë:

- | | |
|------------------------------------|---------------|
| a) Biologji mjedisore | 50 000 lekë ; |
| b) E drejta private dhe e biznesit | 50 000 lekë. |

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që i ndjekin këto programe studimi, si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Biologji mjedisore 200 000 lekë ;
 b) E drejta private dhe e biznesit 78 000 lekë.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.
 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.
 Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1164, datë 25.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTO PROGRAME STUDIUMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në:

a) “Shkencat gjuhësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në Shkencat Gjuhësore”

b) “Shkencat letrare”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në Studime Letrare”.

c) “Shkencat etnologjike dhe folklor”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në Shkencat Etnologjike dhe Folklor”.

ç) “Shkencat historike”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në Shkencat Historike”.

d) “Shkencat arkeologjike”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në Shkencat Arkeologjike”.

2. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

3. Kohëzgjatja e programeve të mësipërme të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, për vitin 2009-2010, është 70 dhe ndahet, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----------|
| a) Në “Shkencat gjuhësore” | 15 kuota; |
| b) Në “Studime letrare” | 15 kuota; |
| c) Në “Shkencat etnologjike dhe folklor” | 10 kuota; |
| ç) Në “Shkencat historike” | 20 kuota; |
| d) Në “Shkencat arkeologjike” | 10 kuota. |

5. Nga kuotat e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, për çdo program studimi, caktohen, për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, kuotat e mëposhtme, për programin e doktoratës në:

- | | |
|---------------------------------------|----------|
| a) “Shkencat gjuhësore” | 5 kuota; |
| b) “Studime letrare” | 5 kuota; |
| c) “Shkencat etnologjike dhe folklor” | 5 kuota; |

- d) "Shkenca historike" 5 kuota;
e) "Shkenca arkeologjike" 5 kuota.

6. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të trojeve shqiptare përkatëse.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit, për këto programe të plotë studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Qendra e Studimeve Albanologjike.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Studimeve Albanologjike.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1165, datë 25.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË "SHKENCA KOMUNIKIMI", NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTË PROGRAM STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në "Shkenca komunikimi", me këto profile:

a) Komunikim- informim, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi", me profil komunikim-informim.

b) Komunikim masiv, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi", me profil komunikim masiv .

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009 - 2010.

3. Kohëzgjatja e programit të mësipërm të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30.

5. Nga kuota e mësipërme caktohen dy kuota për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare përkatëse.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këtë program të plotë studimi, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1166, datë 25.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTO PROGRAME STUDIUMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Analizë dhe algjebër”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në analizë dhe algjebër”.

b) Doktoratë në “Metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike”.

2. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

3. Kohëzgjatja e programeve të mësipërme është, të paktën, 3 vite akademike, si dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 20 dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në analizë dhe algjebër, 10;

b) Doktoratë në metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike, 10.

5. Nga numri i secilës prej kuotave të mësipërme të çdo programi studimi, 1(një) kuotë caktohet për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste, të caktuara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1167, datë 25.11.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 855, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE MINIERAVE, TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.855, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 4/1 e 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përcaktohen 10 (dhjetë) kuota për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare përkatëse.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1168, datë 25.11.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 825, DATË 29.7.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN E MJEKËSISË VETERINARE, TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË
TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFËS PËR KËTË
PROGRAM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.825, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 4/1 e 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë përcaktohen 5 (pesë) kuota, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve përkatëse zyrtare të vendeve nga vijnë kandidatët.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1169, datë 25.11.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 854, DATË 5. 8. 2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE DHE NË ATË TË MJEKËSISË, TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.854, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 4/1 e 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Për kandidatët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, përcaktohen 10 (dhjetë) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 40 (dyzet) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve përkatëse zyrtare të vendeve nga vijnë kandidatët.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1170, datë 25.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË” (MNP),
DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMEVE DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT
PËR KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), në “Fizioterapi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP) në fizioterapi”.

2. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” (MNP) realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit akademik.

3. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këtë program, për vitin akademik 2009-2010, të jetë 30.

5. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1193, datë 3.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRKTHIMIT TË PYETËSORIT TË KOMISIONIT EUROPIAN, NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, të ligjit nr. 10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të shkronjës “d” të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Integrimit organizon procesin e përzgjedhjes së përkthyesve për përkthimin dhe rishikimin e përkthimit të pyetësorit të Bashkimit European. Për këtë qëllim, Ministria e Integrimit ndjek këto procedura:

- a) Shpall lajmërimin për përzgjedhjen e përkthyesve;
- b) Përcakton kriteret për përzgjedhjen e tyre;
- c) Përcakton numrin e përkthyesve që do të përfshihen në këtë proces;
- ç) Ndan punën ndërmjet përkthyesve sipas kapitujve/nënkapitujve të pyetësorit;
- d) Kujdeset për unifikimin e terminologjisë, gjatë procesit të përkthimit.

2. Vlerësimi i kandidatave bëhet nga një komision vlerësimi, i ngritur me urdhër të Ministrit të Integrimit.

3. Lista e përkthyesve të përzgjedhur miratohet nga Ministri i Integrimit, me propozim të komisionit të vlerësimit.

4. Tarifa e shpërblimit për përkthimin dhe rishikimin e përkthimit për një faqe kompjuterike është 2000 (dy mijë) lekë, sipas standardeve të miratuara nga Ministri i Integrimit.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Integrimit.

6. Ngarkohet Ministria e Integrimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1197, datë 3.12.2009

**PËR SHPALLJEN E KALASË SË TIRANËS “ZONË ARKEOLOGJIKE “A”” DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E ADMINISTRIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË KALASË SË TIRANËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllin përcaktimin e rregullave për administrimin dhe zonifikimin e zonës arkeologjike “A” të Klasë së Tiranës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar).

Neni 2
Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A”

Në zonën arkeologjike “A” të Kalasë së Tiranës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i mureve rrethuese dhe strukturave të tjera të kalasë, kryerja e sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Restaurimi i monumenteve të kulturës që përfshihen brenda kufijve të zonës arkeologjike mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Rikonstruksioni i rrugëve në të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 3

Në studimet urbanistike për qendrën e Tiranës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i Kalasë së Tiranës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Neni 4


Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht bazuar në të dhënat e reja arkeologjike si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 5

Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet:

1. Harta e zonifikimit me koordinatat përkatëse gjeografike të marra GPS (Garmin 60).

ZONA ARKEOLOGJIKE "A" E KALASË SË TIRANËS



UDHËZIM
Nr.47, datë 26.11.2009

**PËR MËNYRËN DHE AFATET E KRYERJES SË PAGESËS SË DETYRIMEVE LIGJORE
TË SUBJEKTEVE TË MIRATUARA DHE TË LICENCUARA NË FUSHËN E LOJËRAVE
TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogarinë bankare të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në një nga bankat e nivelit të dytë 0.5 për qind të xhiros vjetore, si më poshtë:

a) Për vitin 2009, brenda datës 15.12.2009 duhet të derdhen shumat e mëposhtme:

i. 2 000 000 lekë shoqëritë e licencuara për kazino dhe lotari kombëtare.

ii. 1 500 000 lekë shoqëritë që organizojnë kazino elektronike.

iii. 1 000 000 lekë shoqëritë që organizojnë baste sportive dhe baste për gara në pistë.

iv. 300 000 lekë në vit për shoqëritë që organizojnë bingo tradicionale e televizive.

b) Brenda datës 31.3.2010, pjesën tjetër të detyrimit të vitit 2009 e mbetur pa u paguar, e cila plotëson vlerën 0.5 për qind të xhiros vjetore.

c) Për vitin 2010 e në vazhdim, pagesat do të bëhen me katër këste, si më poshtë vijon:

i. Kësti i parë, brenda datës 10 prill,

ii. Kësti i dytë, brenda datës 10 korrik,

iii. Kësti i tretë brenda datës 10 tetor,

iv. Kësti i katërt, brenda datës 10 janar (i vitit pasardhës).

ç) Detyrimi i shoqërive të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit llogaritet si detyrim vjetor. Periudha e detyrimit vjetor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit në vazhdim. Nëse veprimtaria në fushën e lojërave të fatit krijohet ose pushon brenda kësaj periudhe, detyrimi i shoqërive llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

2. Pagesat e kryera më 31 mars për vitin 2009 dhe çdo 10 prill për vitin 2010 e në vijim, do të shoqërohen patjetër edhe me dorëzimin pranë NJMLF-së të një kopje të bilancit dhe të pasqyrave të tjera financiare.

3. Vlera e gjobës nga ana e kundërvajtësit duhet të derdhet 100 për qind në llogarinë bankare të NJMLF-së, dhe NJMLF-ja xhiron në llogarinë e buxhetit 80 për qind të vlerës së gjobës.

4. NJMLF-ja hap llogari likuiduese në një nga bankat e nivelit të dytë si person juridik publik, ku do të depozitohen të ardhurat nga pagesat që bëjnë shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit, sipas nenit 12 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008, të ndryshuar, si dhe të ardhurat e siguruara nga vjelja e gjobave sipas nenit 49 të ligjit.

5. Likuiditetet e kësaj llogarie nuk do të përdoren nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit gjatë vitit 2009, por do të shërbejnë si burim financimi për vitin 2010.

6. Financimet e marra nga Buxheti i Shtetit që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 149, datë 28.9.2009 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, do t’i kthehen Buxhetit të Shtetit gjatë vitit 2010.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode

KËRKESË
Nr.7163, datë 8.12.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga Kodër Kamëz-Kamëz”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 13 450 656 (trembëdhjetë milionë e katëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRASNPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË (TOKË+OBJEKTE) TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KODËR
 KAMËZ-QENDËR KAMËZ”

							LLOJI I PASURISË									
							TRUALL			ARË			Objektet	Vlera (lekë)	Shuma në lekë	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Vërtetim pronësie nr.pronësie	Sipërf.përgj.m²	m²	Çmimi	VI.lekë	m²	Çmimi	VI.lekë				
1	Shkëlqim Marjana		Hajdari	8320	,1/81	nd.125							lokal 1kt	2037374	2037374	Konf.zvrpp
2	Enver		Zyberi	2066	81/11	2366				66	626	41316			41316	Konf.zvrpp
3	Ramazan		Nika	2066	129/148	Tr.400, nd.252							karburant	2670234	2670234	Konf.zvrpp
4	Isuf		Bendo	2066	42dt.23/02/05	37.5	5	2650	13250				lokal 32kt	1530522	1543772	Konf.zvrpp
5	Bashkëpronarët		Ismaili	8320	1/142	440	237	20473	4852101						4852101	Konf.zvrpp
6	Korab		Zyberaj	2066	953dt.07/12/05	172							Mur rreth.	1200644	1200644	Konf.zvrpp
7	Qemal		Jonuzi	2066	112dt.28/4/07	13.5		2650					lokal	1001925	1001925	Konf.zvrpp
8	Petro		Gjergji	2066	81/20	1064				62	626	38812			38812	Konf.zvrpp
9	Sabri		Spahiu	2066	81/18	1024				35	626	21910			21910	Konf.zvrpp
10	Riza		Maloku	2066	129/241	2308				68	626	42568			42568	Konf.zvrpp
	Shuma:						242		4865351	231		144606		8440699	13450656	

KËRKESE

Shtetësja Xhevrije Mara kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Lutfi Mara, i datëlindjes 5.1.1962.

KËRKUESJA
Xhevrije Mara

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 16.12.2009
Doli nga shtypi më 16.12.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë